

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklarata - Trump refuzon marrëveshjen e Iranit për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit brenda shtatë ditësh
ADRESA	https://www.syri.net/bote/919375/trump-refuzon-marreveshjen-e-iranit-per-rihapjen-e-ngushtices-se-hormuzit-brenda-shtate-ditesh/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 16:47:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 16:40:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5c1e35a53a2f5666090bbab4b3a66a3eeb713ff6cc78b6d6f0f9dc649d483b27
TEKSTI	6d290ecf617ac9a81da573ba12cd04c59d4e21a3f60b1e85d2fa0bffa9b3c6a01
PAMJA	039800cb3115fd0aa3d3f4c11809d68f335cf82b9b1225963bdc401956ee0660

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0dfb42424b66d8a5fdbbf308738197ad026401709e0dacab5e64c7bff60d74cc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f11c1668384a0114026088dd439e5bbabdb3d48a586475de97c9d12c35b4ba6b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0dfb42424b66d8a5fdbbf308738197ad026401709e0dacab5e64c7bff60d74cc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**FATMIR MEDIU**

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën

**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve



Trump refuzon marrëveshjen e Iranit për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit brenda shtatë ditësh

18:40, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Presidenti i SHBA-së, Donald Trump nuk pranon propozimin e Iranit për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit për transportin tregtar brenda një jave.

Duke folur për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë, Trump tha se Teherani "dëshiron të bëjë një marrëveshje për ta hapur menjëherë ngushticën, sepse po humbet shumë".

Të premtën, ministri i Jashtëm iranian, Abbas Araghchi, u tha gazetarëve në OKB në Nju Jork se një marrëveshje mund të arrihet "nëse plotësohen kushtet e nevojshme". Sipas tij, këto kushte janë të përcaktuara në një memorandum mirëkuptimi (MOU) të nënshkruar nga dy vendet në qershor.

Ngushtica strategjike, përmes së cilës transportohet rreth një e pesta e furnizimit botëror me gaz dhe naftë, është praktikisht e mbyllur që nga shpërthimi i luftës në shkurt.

"Po e refuzoj marrëveshjen e tyre", tha Trump të shtunën, duke shtuar se SHBA-ja tashmë ka "kontroll të plotë" mbi ngushticën, përmes së cilës kalojnë "sasi masive naftë".

"Ata duan të bëjnë një marrëveshje dhe mendoj se kjo është në rregull. Edhe mua më pëlqen të bëj marrëveshje. Por kjo marrëveshje nuk do të ishte e pranueshme", shtoi ai.

Të premtën, Wall Street Journal, duke cituar zyrtarë amerikanë, raportoi se Trump është skeptik se Irani do t'i përmbyshë kërkesat e tij dhe se ai u ka thënë bashkëpunëtorëve se e sheh si të mundshme rifillimin e një fushate bombardimesh.

Irani iu përgjigj sulmeve ajrore amerikane dhe izraelite, të nisura në fund të shkurtit, duke sulmuar Izraelin dhe bazat amerikane në Gjirin Persik, si dhe aleatët arabë të SHBA-së në rajon. Në të njëjtën kohë, Teherani bllokoi Ngushticën e Hormuzit.

Mbyllja e ngushticës ka shkaktuar luhatje të forta të çmimeve të energjisë.

më të lexuarat



Takimi me Trump, Zelensky i gatshëm të takohet me Putin: Në çdo kohë



SHBA e fton Putinin në samitin e G20-së



Për herë të parë në histori! Agjenti i AI hakeron portalin qeveritar australian, sulmi u zbulua disa javë me vonë



Rritet bilanci i viktimave amerikane në luftën me Iranin



Gjykata urdhëron Trumpin të rikthejë aksesin për CNN, MS NOW dhe Politico



Rodos: Makth i dyfishtë për 44-vjeçaren polake nga 28-vjeçari shqiptar: Ai i mori 15,000 euro dhe kur ajo ia kërkoi...



Ambasadori amerikan: Trump e naralaimëroi Xinë që të mos e mbështesë

Efektet ekonomike kanë rritur gjithashtu presionin ndaj Trump për të gjetur një mënyrë për t'i dhënë fund konfliktit, veçanërisht ndërsa SHBA-ja i afrohet zgjedhjeve për Kongresin në nëntor.

"Nëse plotësohen kushtet e nevojshme, ngushtica mund të rihapet dhe qarkullimi normal detar mund të rikthehet brenda shtatë ditësh", u tha Araghchi gazetarëve të premtën.

Ai nuk specifikoi se cilat hapa kërkon Irani që të ndërmarrë SHBA-ja, por shtoi se *"veprimet që duhet të ndërmarrin Shtetet e Bashkuara nuk janë të reja. Ato janë të gjitha të përcaktuara tashmë në memorandumin e mirëkuptimit".*

"Mund t'ju them se nëse pala amerikane është serioze për të arritur një marrëveshje dhe për të rihapur Ngushticën e Hormuzit, gjithçka është tashmë gati", shtoi ai. "Tani zgjedhja i takon Shteteve të Bashkuara."

Ndërkohë, Presidenti iranian Masoud Pezeshkian i tha CBS News, partnerit amerikan të BBC-së: *"Ne kishim arritur më parë një marrëveshje bazuar në memorandumin e mirëkuptimit që u nënshkrua në Pakistan... nëse Shtetet e Bashkuara bien dakord të vazhdojnë në këtë mënyrë, gjithçka do të kthehet siç ishte më parë."* /BBC/

© SYRI.net

Lexo edhe:



Franca dhe Statujën e Lirisë, Kina dërgon panda. Domethëniet e dhuratave diplomatike - si zgjidhet një e tillë?




Mijëra njerëz përshëndesin Papën në Paris për Meshën në natyrë



The Atlantic: Edhe Egjipti e paralajmëroi Izraelin për kërcënimin e Hamasit

Iranin



DW/ A do ta ekstradojë Kroacia të dyshuarin për shpërthim?



14 të vdekur në Detin Kaspik, ushtarakët kazakë u përfshinë nga dallgët gjatë stërvitjes

TË NGJASHME



The Atlantic: Edhe Egjipti e paralajmëroi Izraelin për kërcënimin e Hamasit



Ministrat e Jashtëm të Rusisë dhe Gjermanisë, bisedimet e para që nga fillimi i luftës në Ukrainë



Zgjedhjet për Dumën Shtetërore në Rusi - Zelensky miraton sanksione kundër 44 individëve



Belgjika bën thirrje për Frontex më të fortë dhe kthime më efektive të emigrantëve



OKB/ Kina kundërshton 'veprimet ushtarake të njëanshme' mes luftës SHBA-Iran



Erdogan: Kriminelët e luftës i përkasin sallave të gjyqit, jo tribunës së OKB-së



11 të pandehur për gjyq në Francë për vrasjen e 16-vjeçarit, akuzohen edhe për motive racore

LAJME POLITIKE KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MUEBIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net